



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:246860

Datë: 29.07.2022

Numri i dokumentit: 03278360

Ac.nr.9776/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj kryetare e kolegjit, Gani Avdiu dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, H.H nga Obiliqi, ... të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Z.SH nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), sheshi “Nëna Terezë”, nr.36, Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Gëzim Bërbatovci, për paga jubilarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga e paditura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.5480/20, i datës 27.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 26.07.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. **APROVOHET** e themeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), sheshi “Nëna Terezë”, nr.36, Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.5480/20, i datës 27.07.2021 dhe gjykohet si vijon: **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit H.H nga Obiliqi, me të cilën ka kërkuar që të “detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), që paditësit H.H, t’ia paguaj tri (3) paga në emër të shpërblimit jubilar në shumë prej 1,963.25 euro, me kamatë ligjore prej 8%, të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm”, **si e pa bazuar**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.5480/20, i datës 27.07.2021 ka vendosur si në vijim:

“I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.H, nga Obiliqi.

II. DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, që paditësit H.H në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të tri pagave t’ia paguaj shumën prej 1,963.25€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 06.02.2019 kur është parashtruar padia e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 394.00€, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.”

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovohet ankesa si e bazuar si dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të paditurës dhe i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj ankesën e të paditurës si të pa bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 (pika e) dhe 201 (pika d), të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi ka ushtruar padi me datë 06.02.2019 në Gjykatën e shkallës së parë duke kërkuar që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia njoh të drejtën për pagesën e tri pagave jubilarë në shumë prej 1,963.25 euro me kamatë prej 8%. Kërkesëpadinë e tij paditësi e ka mbështetur në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.305/19 të datës 22.11.2019, e ka aprovuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr.2331/2020 të datës 10.12.2020 e ka prish aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.305/19 të datës 10.12.2019, ndërsa çështjen e ka kthyer në rigjykim në shkallë të parë.

Gjykata në rigjykim me aktgjykimin C.nr.5480/20 të datës 27.07.2021 e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka theksuar nga provat e administruara dhe faktet e vërtetuara gjykata gjeti se paditësi i ka mbi 40 vite përvojë pune tek e paditura dhe se të njëjtit

nuk i janë kompenzuar tri paga në emër të shpërblimit jubilar në vlerë prej 3 pagave mujore të parashikuara sipas dispozitës së nenit 52 par. 1.3 të MPKK-së. Gjykata duke ju referuar nenit 52 të MKPP-së dhe dy vendimeve të të paditurës, vendimi me nr. 2244 i datës 10.04.2019 dhe vendimi nr. 8 Nr. 8261 i datës 23.08.2019, gjeti se e paditura ka pasur për detyrë që paditësit t'ia kompensoj tri paga në emër të shpërblimit jubilar.

Më tej ka shtuar se lartësinë e pagës mujore për muajt janar, shkurt dhe mars 2019 e ka realizuar në shumë prej 654.41 €, gjykata e vërtetoi nga lista e pagës, nga e cila u vërtetua se paditësi e ka pasur pagën në vlerën e lartcekur. Nga Vendimi me nr.2829 i dt. 10.05.2019 gjykata vërtetoi se e paditura i'a ka njohur paditësit të drejtën për pagesën e shumës prej 1,758.00 € në emër të 3 pagave me rastin e pensionimit të cilat edhe ia ka paguar sipas listës së pagës.

Më tutje në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar ka shtuar se objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit ishin pretendimet e të paditurës KEK sh.a në Prishtinë, se në kohën e parashtrimit të padisë nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive dhe se kërkesa e paditësit është e parashkruar, por gjykata gjeti se pretendimet e të paditurës janë të pabazuara, kjo për faktin se paditësi ka mbi 40 vite të përvojës së punës tek e paditura. Me Vendimet e të paditurës: me nr. 2244 i dt. 10.04.2019 dhe nr. 8261 i dt. 23.08.2019 në pikën 1 është vazhduar njohja e obligimit për pagesën e pagave jubilarë deri me dt. 31.12.2019 dhe në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar se punëmarrësit me 40 vite përvojë pune, janë barazuar me punëtorët që kanë arritur përvojën 30 vjeçare, duke ju njohur kjo e drejtë. Andaj, me këto vendime është ndërprerë edhe çfarëdo parashkrimi në të cilën e paditura pretendon. Për këto shkaqe dhe arsye gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar. Gjykata vlerëson se e paditura sipas nenit 52 par 1.3 të MPKK-së ka pasur për detyrim që brenda 30 ditësh pas plotësimit të kushteve të parapara sipas këtij neni, që paditësit t'ia paguaj pagat jubilarë, e meqenëse e paditura nuk i'a ka paguar ato, paditësi ka paraqitur padi në gjykatë për realizimin e kësaj të drejte. Paditësi me kërkesën nr. 62 e dt. 17.01.2019 i ishte drejtuar të paditurës për pagesën e shpërblimit jubilar, për 30 vite të përvojës së punës. E paditura me përgjigjen nr.502 e dt. 24.01.2019 kishte refuzuar kërkesën e paditësit si të pabazuar, me arsyetim se e paditura mban e drejtën për pagesën e pagave jubilarë varësisht nga rezultatet e afariste financiare të paditurës. Por, gjykata gjeti se kjo nuk mund të përdoret si justifikim sepse e paditura nuk ka përpiluar raport të hollësishëm në lidhje me rezultatet e punës, por edhe sikur të kishte një raport të tillë pagat jubilarë janë parashikuar me Kontratën kolektive dhe këtë të drejte të punëmarrësve, e paditura ka vazhduar ta njoh me vendimet e saj me nr. 8261 dhe me nr. 2244, si obligim të saj për pagesën e pagave jubilarë deri me dt. 31.12.2019. më tej ka shtuar se gjykata gjeti se e paditura me Vendimet e saj nr. 2244, i dt. 10.04.2019 dhe Vendimin nr. 8261 i dt. 23.08.2019 ka, në pikën 1 dhe 4 ka vazhduar njohjen e obligimit për pagesën e pagave jubilarë për të gjithë punëtorët të cilët i kanë plotësuar kushtet deri me dt. 31.12.2019, duke i barazuar punëtorët të cilët i kanë arritur 40 vite të përvojës së punës sikurse ata që kanë 30 vite përvojë pune.

Më tej gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka shtuar se sipas dispozitës së nenit 245 të LMD-së është parashikuar që “Kreditori në Marrëdhënie Detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka

mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj borxhin në shumat e gjykuara.

Lidhur me kamatën ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë pjesërisht është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, por Gjykata e Apelit duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare gjeti se e drejta materiale nuk është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore - LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata ankimore gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjen se gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, sepse pas shikimit të shkresave të lëndës kjo Gjykatë gjeti se padia e paditësit është paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor dhe si e tillë do të duhej të refuzohej si e pa bazuar për shkak të parashkrimit.

Nga shkresat e lëndës vërehet se paditësi H.H tek e paditura ka më shumë se 40 vite përvojë pune e kjo vërtetohet nga kartela e punëtorit e lëshuar nga e paditura. Po ashtu nga shkresat e lëndës vërehet se paditësi ka bërë edhe kërkesë pranë të paditurës për pagesën e tri pagave jubilarë, mirëpo kjo kërkesë është refuzuar nga e paditura si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit gjen se paditësi 30 vite të përvojës së punës i ka arritur në vitin 2011, ashtu që në atë periudhë edhe i ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin e pagës jubilarë nga e paditura, mirëpo në periudhën kur paditësi e ka mbushur jubilenë, nuk ka pasur kontratë kolektive në fuqi, andaj nuk ka bazë ligjore për të kërkuar kompensim, pra në rastin konkret nuk është me rëndësi shumë periudha kur është kërkuar pasi çështje paraprake është se a ka pasur në fuqi kontratë kolektive në kohën e përmbushjes së kushtit për kompensim të pagës jubilarë. Meqenëse në vitin 2011 në kohën kur paditësi i ka mbushur 30 vite të përvojës së punës, ka munguar baza ligjore, kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata vendosi që të ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në rastin konkret edhe sikur të ekzistonte baza ligjore për të kërkuar kompensim pra sikur të kishte qenë në fuqi kontrata kolektive në vitin 2011, vit kur paditësi e ka plotësuar kushtin pra përmbushja e jubilesë, nga ajo kohë e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar më tepër se 3 vite sikurse përcaktohet me nenin 87 të Ligjit të Punës, dhe padia e tillë është e paraqitur pas afatit ligjor.

Kjo Gjykatë po ashtu vëren se në padi dhe kërkesëpadi, paditësi ka kërkuar vetëm kompensimin e 3 pagave jubilarë dhe jo atyre përcjellëse sepse vërehet se paditësi tani më është pensionuar dhe këtë fakt Gjykata e Apelit e vërteton me vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të lëshuar nga e paditura me datë 08.04.2019.

Marrëveshja e përgjithshme Kolektive të cilës i është referuar gjykata e shkallës së parë ka hyrë në fuqi më 01.01.2015 dhe është paraparë të jetë në fuqi për periudhën prej 3 viteve, ku gjatë kësaj periudhe janë obliguar nënshkruesit e saj që këtë marrëveshje ta zbatojnë në tërësi.

Paditësi kërkesën për pagesën e tri pagave jubilarë pranë të paditurës e ka parashtruar me datë 17.01.2019, ndërsa padinë pranë Gjykatës kompetente e ka parashtruar me datë 06.02.2019.

Në rastin konkret pala e paditur është thirrur në parashkrim të kërkesës, dhe gjykata e ka detyrim ligjor që të vlerëson një pretendim të tillë. Me nenin 87 të Ligjit të Punës përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, që do të thotë se të gjitha kërkesat në para parashkruhen brenda afatit 3 vjeçar nga dita e lindjes së të drejtës për të kërkuar. Paditësit e drejta për të kërkuar pagat apo shpërblimet jubilarë i është krijuar me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me datë 01.01.2015, nga kjo datë deri me 01.01.2018 paditësi ka pasur mundësi ta paraqes padinë. Pas datës 01.01.2018 pala humb të drejtën që të kërkojë shpërblimin jubilar sepse një kërkesë e tillë është e parashkruar apo vjetërsuar sepse është paraqit pas afatit ligjor.

Në raport me dispozitat e LMD-së të cekura nga gjykata e shkallës së parë, të njëjtat do të mund të gjenin zbatim vetëm nëse do të ishte në fuqi Marrëveshja në fjalë dhe në qoftë se kërkesa nga marrëdhënia e punës në para nuk do të ishte parashkruar, e meqenëse e njëjta nuk ka qenë në fuqi dhe kërkesa është parashkruar pala e paditur nuk i detyrohet paditëse në asnjë pagesë apo borxh siç i referohet gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit vendimin për shpenzimet e procedurës, që secila palë të bartë shpenzimet e saj të procedurës e ka bazuar në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, pasi palët nuk kanë parashtruar kërkesë për shpenzimet e procedurës.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën e) e lidhur me nenin 201 par.1 nën pikën d) të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9776/21 me datë 19.07.2022

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj,d.v.